

# ANALIZË E ZBATIMIT TË STRATEGJISË PËR HETIME FINANCIARE DHE PRAKTIKA E KONFISKIMIT TË PRONËS

**Rezume dhe analizë e zbatimit të Strategjisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për fuqizim të kapaciteteve për udhëheqje të hetimeve financiare dhe konfiskim të pronës dhe Plani aksionar për zbatimin e saj**

Sllagjana Taseva, Mirko Mitevski

**Konfiskimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

Natali Petrovska, Darko Avramovski



Studimi është i përgatitur për Platformën e organizatave civile për luftë kundër korrupsionit. Ky studim është i ndihmuar nga Resilience Fund, të Iniciativës Globale kundër krimit të organizuar transnacional. Të gjitha mendimet dhe qëndrimet e shprehura në studimin janë përgjegjësi e autorëve të tekstit dhe nuk janë në mënyrë të nevojshme mendime dhe qëndrime të Iniciativës Globale ose të Platformës.

# Impresum

—

**Titulli:** Analizë e zbatimit të Strategjisë për hetime financiare dhe praktika e konfiskimit të pronës

**Botues:** Instituti për demokraci "Societas Civilis" - Shkup

**Autorë:** Slagjana Taseva, Marko Mitevski, Natali Petrovska, Darko Avramovski

**Lektore:** Valentina Joshevska

**Përkthim:** Mustafa Peza

**Dizajn:** Matea Londza Shumkovska

Publikimi mund të merret falas në:

<http://www.antikorupcija.mk/>

Studimi është i përgatitur për Platformën e organizatave civile për luftë kundër korrupsionit. Ky studim është i ndihmuar nga Resilience Fund, të Iniciativës Globale kundër krimit të organizuar transnacional. Të gjitha mendimet dhe qëndrimet e shprehura në studimin janë përgjegjësi e autorëve të tekstit dhe nuk janë në mënyrë të nevojshme mendime dhe qëndrime të Iniciativës Globale ose të Platformës.

# Përmbajtje

—

<b>Rezyme dhe analizë e zbatimit të Strategjisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për përforcimin e kapaciteteve për zbatimin e hetimeve financiare dhe konfiskim të pronës si dhe Plani Aksionar për zbatimin e tij</b>	5
Qëllimi i strategjisë	6
Përfshirja e strategjisë	7
Masa për fuqizimin e efikasitetit dhe të bashkëpunimit ndër-resorësh	8
Fuqizimi dhe harmonizimi i kornizës juridike	9
Fuqizimi i kapaciteteve përmes trajnimeve	10
Mbrojtja e të drejtave të njeriut	11
Aktivitete të ndërmarra në pajtim me Planin Aksionar për zbatimin e strategjisë nga MPB, DPF dhe DDRM	11
Dobësi në bashkëpunimin ndër-resorësh	12
Kapacitete të Republikës së Maqedonisë së Veriut për luftë kundër krimit sipas Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2020	13
<b>Konfiskim në Republikën e Maqedonisë së Veriore</b>	15
Konfiskimi në legjislativin në Republikën e Maqedonisë së Veriut	16
Konfiskimi në Kodin Penal	17
Procedurë për konfiskim sipas Ligjit për procedurë penale	21
Zbatimi praktik i masës së konfiskimit	23
<b>Konkluzione dhe rekomandime</b>	29



**Rezime dhe analizë e zbatimit të Strategjisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për fuqizim të kapaciteteve për udhëheqje të hetimeve financiare dhe konfiskim të pronës dhe Plani aksionar për zbatimin e saj**

Sllagjana Taseva, Mirko Mitevski

## Qëllimi i strategjisë

Me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve për udhëheqje të hetimeve financiare dhe të konfiskimit të pronës, si dhe të fuqizimit të efikasitetit në luftën kundër veprave më të rënda penale, krimit të organizuar, krimit financiar dhe ekonomik, tregtisë së palejuar, korrupsionit, larjes së parave e të tjera, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në gusht të vitit 2017 solli vendim për miratimin e Strategjisë për fuqizim të kapaciteteve për realizim të hetimeve financiare dhe të konfiskimit të pronës, me Planin Aksionar për zbatimin e saj në periudhën prej vitit 2018 deri në vitin 2020.

Qeveria e miratoi strategjinë në janar të vitit 2018, ndërsa implementimi i saj u shty dhe u ngadalësua për shkak se nuk u soll vendim për themelimin e Komisionit Nacional, si trup për mbikëqyrje mbi zbatimin e strategjisë, e që është i përbërë nga përfaqësues të institucioneve kompetente për zbatimin e hetimeve financiare. Ky trup, sipas Strategjisë, duhej të ishte kompetent që të përgatis dhe ti dërgojë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë

së Veriut raporte tremujore për vazhden e zbatimit të strategjisë. Gjithashtu, Komisioni kombëtar duhej ti analizonte problemet dhe ti koordinonte aktivitetet për zbatimin efikas të strategjisë. Gjithashtu, gjatë tre viteve të kaluara nuk ishte përcaktuar buxhet për zbatim të strategjisë.

Strategjia përbëhet nga tri pjesë: Nevojë për miratim të strategjisë në të cilën janë përfshirë nocioni, qëllimet e strategjisë, deklaratë strategjike dhe vizion si dhe instrumente ndërkombëtare; Analizë e kornizës nacionale institucionale dhe juridike për zbatimin e hetimeve financiare dhe në pjesën e tretë janë përcaktuar Prioritetet Strategjike, zbatimi dhe mbikëqyrja mbi zbatimin e strategjisë.

Strategjia përfshin periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2020 dhe është komplementare me Strategjinë Kombëtare për luftë kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit të miratuar për periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2020 dhe me dokumentet e tjera strategjike.



## Përfshirja e strategjisë

—

Strategjia paraqet dokument, i cili i radhit prioritetet dhe i definon aktivitetet që duhet të ndërmerren, me qëllim të avancimit të kapaciteteve për zbatim të hetimeve financiare dhe të sistemit për konfiskim të pronës dhe përmban qasje gjithëpërfshirëse ndaj hetimeve financiare, për zbatimin e të cilave kompetente janë Prokuroria Publike, Ministria e punëve të brendshme, Drejtoria e doganave, Drejtoria për polici financiare si dhe organe të tjera kompetente.

Me analizën e kornizës juridike dhe të kapaciteteve institucionale për zbatimin e hetimeve financiare dhe të masës për konfiskim janë identifikuar një numër i madh i masave që u sistemuan në **pesë qëllime strategjike** të strategjisë, e ato janë:

- I. Organe efikase për zbatim të hetimeve financiare;
- II. Bashkëpunim i përforcuar dhe efikas ndërresorësh;
- III. Fuqizimi dhe harmonizimi i kornizës juridike;
- IV. Fuqizimi i kapaciteteve përmes trajnimeve dhe
- V. Mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Me qëllim të zbatimit efikas të strategjisë është përgatitur edhe Plan Aksionar në të cilin për çdonjërin nga qëllimet strategjike janë përcaktuar masa dhe aktivitete konkrete që duhet të ndërmerren me qëllim të përmbushjes së tyre; institucionet kompetente dhe ato të përfshira në aktivitetet dhe treguesit e aktiviteteve; korniza kohore si dhe implikimet financiare.

## Masa për fuqizimin e efikasitetit dhe të bashkëpunimit ndër-resorësh

Në raport me rritjen e efikasitetit të organeve për zbatimin e hetimeve financiare me planin aksionar janë paraparë masa për themelimin e qendrave hetuese në prokuroritë publike të cilat procedojnë para gjykatave dhe që kanë kompetencë të plotë, përkatësisht në rajonin e katër prokurorive sipërore publike.

Krahas kësaj, plani aksionar parashikon vendosje të njësisë të posaçme organizative, përkatësisht të njësisë për hetime financiare, të cilat do të zbatojnë hetime financiare në Prokurorinë publike, MPB, DPF dhe DDRM, sigurim të procedurës së qartë si bazë për koordinim nga prokurorët publik që i udhëheqin procedurat dhe hetimet para-hetimore për të dhënë instruksione precize organit për zbatim të ligjit.

Më tutje parashihet vendosja e procedurave të posaçme të brendshme për udhëheqje të hetimeve financiare, paralelisht me hetimet financiare në Prokurorinë publike, MPB, DPF dhe DDRM dhe në institucionet kompetente të cilat janë pjesë e policisë gjyqësore, fuqizimi i kapaciteteve për procedim efikas dhe efektiv të Agjencisë për menaxhim me pronën përkohësisht të sekuestruar, themelimi i zyrës për kthyerje të pronës (ARO) në kuadër të Prokurorisë publike dhe për fuqizim të kapaciteteve institucionale.

Si masa për fuqizim dhe rritje të efikasitetit të bashkëpunimit midis resorëve, në planin aksionar është paraparë mundësimi i paraqitjes së plotë dhe në kohë deri në bazat e të dhënave të të gjitha institucioneve, të cilat disponojnë me të dhëna të nevojshme për procesin e zbatimit të hetimit financiar, procesit të gjetjes së pronës që duhet të konfiskohet dhe për vetë konfiskimin.

Gjithashtu, është paraparë vendosja e evidencës së barazuar statistikore dhe metodologji përkatëse për përcjellje statistikore të hetimeve financiare, të rasteve në të cilat është paraparë masa e ngrirjes së përkohshme të pronës dhe masat për konfiskim nga e cila në mënyrë efikase do të mund të ndiqet se si zbatohen këto masa.

Më tej, është paraparë vendosja e përkrahjes softuerike e cila mundëson përpunimin më të shpejtë dhe më efikas të të dhënave, vendosje të një trupi të përhershëm për ndjekje dhe koordinim në procedimin gjatë konfiskimit, themelim të Komisionit Nacional për ndjekje të implementimit të strategjisë dhe të planit aksionar si dhe aplikim të pjesëmarrjes së përforcuar të shërbimeve, të cilat marrin pjesë në bashkëpunimin ndërkombëtar në hetime dhe këmbimin e informacioneve në procedurat për përcaktimin dhe gjetjen e pronës e cila gjendet në shtet tjetër.

Strategjia parashikon edhe themelim të Zyrove për kthyerje të pronës ose ARO (Asset Recovery Office) në drejtim të harmonizimit me EU-legjislativin, e në lidhje me Vendimin e Këshillit të UE 2007/845/PVR nga data 6 dhjetor të vitit 2007 (neni 1) për bashkëpunim midis Zyrove për kthyerje të pronës në vendet anëtare, në pjesën e ndjekjes dhe të identifikimit të të ardhurave nga një pronë tjetër të ndërlidhur me krimin, është detektuar nevoja për vendosje ose përcaktim të Zyrës Kombëtare për kthyerje të pronës.

Qëllimi i ARO-s është ti lehtësojë ndjekjen dhe identifikimin e përfitimeve nga krimi të cilat mund të bëhen objekt i ngrirjes, marrjes ose të konfiskimit

si pjesë e hetimit penal ose civil. Në pajtim me Vendimin, vendet anëtare mund të vendosin ose të përcaktojnë të paktën dy zyra të tilla. ARO kanë për obligim që të këmbëjnë të dhëna mes vete pavarësisht nga statusi i tyre. Mënyra e bashkëpunimit është i paramenduar ashtu që ARO ose një institucion tjetër i vendit anëtar të UE, që ka kompetenca të ngjashme, mund të këmbëjë informacione me ARO të një vendi tjetër anëtar. Kërkesa duhet të përmbajë të dhëna për: Lëndën dhe shkakun e kërkesës, Natyrën e procedurës dhe Pronën e cila është e targetuar ose kërkuar dhe/ose personat fizik ose juridik për të cilat supozohet se janë të përfshira në lëndën.

## Fuqizimi dhe harmonizimi i kornizës juridike

Në pikëpamjetë fuqizimit dhe harmonizimit të kornizës juridike, Plani Aksionar parashikon përmirësim të dispozitave ligjore në drejtim të mundësisimit që të veprohet në kohë dhe pa shtyrje në lidhje me vendimet gjyqësore për konfiskim; ndryshime në LPP dhe në ligje të tjera në drejtim të aplikimit të procedurës për krijimin e mundësisë ligjore që masat për sigurim të mund të shqiptohen menjëherë kur do të krijohen kushte për fillim të procedurës penale, si dhe për fillimin e procedurës financiare në fillim të procedurës para-hetimore dhe në fuqizimin e zbatimit të kornizës ekzistuese juridike, e cila mundëson që të fillohet me

sigurimin e informacioneve për pronën ,në një fazë të hershme për mënyrën në të cilën do të zbatohen hetimet financiare.

Më tej, plani aksionar parashikon vendosje të sistemit të efikasitetit në zbatimin e dispozitave ligjore për shqiptim të masave paraprake për sigurim dhe konfiskim, miratimin e dispozitave të posaçme procedurale për konfiskim kur, për shkak të pengesave juridike, nuk është i mundur realizimi i procedurës penale kundër kryerësit të veprës penale, ndryshimi i Ligjit për menaxhim me pronë të konfiskuar, me qëllim

që të mundësohet që në procedurat kundër AMPM të përfshihet edhe Zyra e avokatit të shtetit dhe të mundësohet ndihmë juridike dhe përfaqësim gjatë tërë procedurës, si dhe fuqizimi i dispozitave juridike të të drejtës së pronës të garantuar me Kushtetutë në procedurat për sekuestrim dhe konfiskim. Strategjia parashikon edhe ndryshim ligjor në drejtim të vendosjes së obligimit të AMPM-së që ta informojë gjykatën e cila e ka shqiptuar vendimin gjyqësor dhe Avokatin shtetëror për çdo pamundësi për zbatimin e plotë të vendimit gjyqësor.

Krahas risive të tjera, strategjia propozon edhe miratim të dispozitave të posaçme procedurale për Konfiskim, kur për shkak të pengesave juridike nuk është e mundur që të zbatohet procedurë penale kundër kryerësit të veprës penale. Kjo në esencë paraqet konfiskim civil për të cilin nuk ekziston procedurë përkatëse e parashikuar me ligj (LPP, ligj tjetër).

## Fuqizimi i kapaciteteve përmes trajnimeve

—

Në pikëpamje të fuqizimit të kapaciteteve përmes trajnimeve në Planin Aksionar është i paraparë trajnim dhe edukim i baraspeshuar dhe i vazhdueshëm në të gjitha institucionet, si dhe zbatimi i trajnimeve të përbashkëta ndër-institucionale dhe multi-disiplinore. Gjithashtu është paraparë edhe trajnim i posaçëm i gjykatësve të cilët vendosin për shqiptim të masës së sigurimit të pronës për konfiskim, si dhe për të shkruar vendime gjyqësore dhe të shqiptime të vendimeve gjyqësore me të cilat zbatohet masa e konfiskimit.

Plani aksionar përfshin edhe zbatim të trajnimit për fuqizim të kapaciteteve të gjykatave të cilat vendosin për masat e përkohshme dhe për masën konfiskim dhe barazim të praktikës gjyqësore si dhe sigurimin e ekspertizës dhe profesionalizimit e specializimit më të ngushtë të të punësuarve në njësitë për hetime financiare në MPB, DPF, DDRM dhe ARO.

## Mbrojtja e të drejtave të njeriut

—

Në pikëpamje të të drejtave të njeriut me planin aksionar është paraparë harmonizim i kornizës nacionale juridike me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, fuqizimi i kapaciteteve

të mbrojtjes së të drejtës së pronës, të garantuar me Kushtetutën dhe motivimi i institucioneve të përfshira në konfiskimin përmes financimit shtesë të bazuar në metodologjinë për shpërndarje të mjeteve, të bazuar në praktikat komparative evropiane.

## Aktivite të ndërmarra në pajtim me Planin Aksionar për zbatim të strategjisë nga MPB, DPF dhe DDRM

—

Mungesa e shërbimeve profesionale dhe limitimi i kapaciteteve institucionale në MPB, DPF dhe DDRM janë të përcaktuara si shkak themelor për implementimin e pamjaftueshëm të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me masat paraprake për konfiskim dhe ngrirje të pronës si dhe masën për konfiskim.

Me qëllim të tejkalimit të këtyre kufizimeve, si një nga aktivitetet e parapara me qëllimin strategjik për organe efikase për zbatim të hetimeve financiare, ishte paraparë edhe formimi i njësive të veçanta

organizative në MPB, DPF dhe DDRM, veprimtaria e të cilave themelore do të jenë hetimet financiare.

Me qëllim të formimit të njësive të tilla organizative u ndryshuan aktet e organizimit dhe të sistematizimit në MPB, DPF dhe DDRM, gjë e cila rezultoi me themelimin të njësive të posaçme organizative për zbatim të hetimeve financiare në të tria institucionet, të cilat tanimë punojnë në lëndë konkrete.

Në kuadër të këtij qëllimi strategjik në MPB, DPF dhe DDRM, si institucione kompetente të cilat janë pjesë

e policisë gjyqësore, janë themeluar grupe pune që punojnë në definim të nevojës dhe përgatitjes së përmbajtjes së procedurës, me qëllim të përgatitjes së procedurave të unifikuara standarde operative, sipas të cilave do të procedojnë të tria institucionet si dhe Prokuroria Publike, e cila gjatë asaj kohe duhet ti përcaktojë edhe procedurat për koordinim të cilat janë të nevojshme për finalizimin e plotë të procedurave standarde operative.

Zyra për kthyerje të pronës ose ARO (Asset Recovery Office) është e vendosur në Prokurorinë e lartë publike në Shkup, ndërsa Prokurori i lartë publik, i cili është udhëheqës i kësaj zyre, tanimë vijon trajnime dhe ka vendosur kontakte me zyrat e tjera ARO, me të cilat duhet të vendoset bashkëpunim në ndjekjen dhe identifikimin e të ardhurave nga pronë tjetër të ndërlidhur me krimin nga shtetet tjera.

## **Kontributi i monitorimit të jashtëm ndaj zbatimit të strategjisë**

Gjatë analizës së zbatimit të strategjisë duhet veçanërisht të theksohet kontributi i monitorimit për zbatimin e Përpjekjeve për luftë kundër korrupsionit, që zbatohet në kuadër të procesit të Berlinit. Sipas rrëfimeve të personave përgjegjës për Strategjinë në Ministrinë e punëve të jashtme, analizat që zbatohen në kuadër të procesit të Berlinit e të cilat e përfshijnë edhe strategjinë, kanë qenë iniciativë për përforsimin e aktiviteteve për zbatim të strategjisë edhe në kushte kur nuk është përcaktuar Koordinator Kombëtar për implementim të strategjisë dhe të planit aksionar. Kjo posaçërisht ka të bëjë me pjesën e vendosjes së kapaciteteve institucionale dhe për formimin e zyrës ARO.

## **Dobësi në bashkëpunimin mes resorëve**

Në raport me fuqizimin dhe rritjen e bashkëpunimit mes resorëve si qëllim strategjik, asnjë aktivitet nuk është zbatuar në tërësi.

Për shkak të qasjes së kufizuar në bazat e të dhënave që i mbajnë MPB, DPF dhe DDRM, qasje jo-efikase në bazat e të dhënave që i udhëheqin institucionet e tjera dhe për shkak të problemeve të shumta administrative që ishin të identifikuar, me planin aksionar ishte paraparë vendosja e sistemit efikas për këmbim të informacioneve dhe mundësim i qasjes në bazat e të dhënave. Për këtë qëllim është themeluar një grup i punës për përcaktim të nevojës për shfrytëzim të këtyre bazave të të dhënave, i cili, si opsion për

mundësim të qasjes në të dhënat të nevojshme për përcaktim të pronës dhe pronësisë së saj, e shqyrton mundësinë për shfrytëzim të kapaciteteve të Qendrës nacionale koordinatave në të cilën marrin pjesë të punësuar nga të tria institucionet.

Me qëllim të grumbullimit dhe të sistematizimit të të dhënave të ndërlidhura me zbatimin e urdhëresave për konfiskim, ngrirje ose sigurim në një vend, gjë e cila do ta kishte sjellë koordinimin e përmirësuar dhe efikasitetin e shtuar, mbetet e hapur pyetja për vendosje të statistikës së barazuar, që mbështetet në metodologji të baraspeshuar për evidencë të procedurave për hetime financiare.

**Si rezultat i paraqitjes së formave të reja të krimit dhe të nevojës së vazhdueshme për bashkëpunim ndërkombëtar, Strategjia si të nevojshme e thekson trajnimin dhe edukimin e vazhdueshëm të nëpunësve në MPB, DPF dhe DDRM por gjithashtu edhe sigurimin e ekspertizës dhe profesionalizimit, si dhe të specializimit më të ngushtë të kuadrove të përfshira në hetimet financiare, me përfshirje të forenzikës financiare. Për atë qëllim është vendosur trajnim i institucionalizuar dhe i barazuar i vazhdueshëm për të punësuarit në MPB, DPF dhe DDRM të cilët janë të përfshirë në hetimet financiare. Në periudhën e implementimit të planit të aksionit, janë realizuar tre trajnime të tilla ,në të cilat kanë marrë pjesë të punësuar nga të tri institucionet.**

## **Përkrahja ndërkombëtare në përmirësimin e kornizës juridike**

Në raport me përmirësimin e kornizës juridike, Ministria e drejtësisë në bashkëpunim me grupin GIZ dhe grupin e ekspertëve, zbaton analizë gjithëpërfshirëse të kornizës juridike dhe në pajtim me theksimet nga strategjia përcaktohen detajet për hapat e ardhshme në përmirësimin e kushteve ligjore për Hetim dhe konfiskim financiar. Gjithashtu, grupi i punës e shqyrton edhe nevojën për përgatitje të ligjit të posaçëm për Zyrën për kthyerje të pronës së konfiskuar (ARO).

## **Kapacitetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut për luftë kundër krimit sipas raportit të Komisionit Evropian për vitin 2020**

Në Raportin e Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2020 theksohet se vendi ka nivel të caktuar të gatishmërisë në luftën kundër krimit të organizuar. Më tej thuhet se korniza ligjvënëse në masë të madhe është në pajtim me standardet evropiane dhe përpjekjet për zbatim të strategjive kundër krimit të organizuar patjetër duhet të vazhdojnë. Deri tani është arritur një avancim i caktuar në sajë të rekomandimit për themelimin të Zyrës për kthyerje të pronës, në pajtim me legjislativin e UE. Zyra tani do të duhet ta tregojë kapacitetin e vet për përkrahje të politikës proaktive në konfiskimin e pronës.

Avancimi në nivelin operativ është shënuar edhe në Raportin e Komisionit Evropian, por është theksuar

se duhet bërë edhe më tepër për tu rritur efektiviteti i institucioneve të cilat i zbatojnë ligjet në luftën kundër formave të caktuara të krimit, siç janë larja e parave dhe krimi financiar.

Bashkëpunimi me Europol është në rritje e sipër në fusha të ndryshme të luftës kundër krimit. Koordinimi mbetet kyç për të gjitha palët e prekura që janë të përfshira në luftën kundër krimit të organizuar.

Kapacitetet organizative të organeve për zbatim të ligjit, gjithashtu vlerësohet se janë të përmirësuara. Sipas raportit, ekziston nevoja që të bëhen përpjekje për vazhdim të zbatimit të Strategjisë për fuqizimin e kapaciteteve për udhëheqjen e hetimeve financiare dhe për konfiskim të pronës.





# Konfiskimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Natali Petrovska, Darko Avramovski

# Konfiskimi në legjislativin në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Në legjislativin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, konfiskimi i pronës rregullohet me tre ligje: Kodin penal (KP), në të cilin janë përcaktuar kushtet për shqiptimin e tij, Ligji për procedurë penale (LPP), në të cilin është rregulluar rrjedha e procedurës për konfiskim të pronës dhe përfitimi nga prona, si dhe Ligji për menaxhim të pronës së konfiskuar, përfitimi nga prona dhe sendeve të konfiskuara në procedurë penale dhe kundërvajtëse (LMPK), në të cilin është paraparë rregullimi i mëtejshëm i kornizës institucionale në raport me ekzekutimin e vendimeve të plotfuqishme gjyqësore për marrje të përkohshme ose të përhershme të pronës. Kjo masë, si masë e posaçme ndëshkuese-përmirësuese të ne, është aplikuar në vitin 2004 me ndryshimet ligjore të kodit penal, por e njëjta, me ndryshimet e ligjit në vitin 2009, që hyjnë në fuqi në vitin 2010 është plotësuar, përkatësisht është sendërtuar me kategori shtesë të të njëjtës – konfiskim i tërthortë dhe i zgjeruar. Në mënyrë shtesë është aplikuar edhe mundësia për konfiskim të pronës dhe të përfitimit nga prona në dobi të një personi juridik. Para aplikimit të këtyre ndryshimeve, mundësia për konfiskim të përfitimit të fituar në mënyrë kundër-ligjore u sigurua përmes institutit konfiskimi i përfitimit nga prona. Por, duke pasur parasysh se i njëjti u përdor jashtëzakonisht rrallë, kryesisht për shkak të pamundësisë së sigurimit të dëshmive juridikisht relevante për përcaktimin nëse prona është përfituar me vepër penale ose bëhet fjalë për fshehje të përkohshme të të njëjtës përmes transaksioneve financiare<sup>1</sup> të të dyshuarit.

Me qëllim të harmonizimit të ligjit penal me konventat e Këshillit të Evropës që janë të ratifikuara nga shteti ynë, e që kanë të bëjnë me luftimin e korrupsionit dhe të krimit të organizuar, hetimet financiare dhe aplikimit të konfiskimit të pronës, por edhe për shkak të harmonizimit të legjislativit të vendit me atë të Unionit Evropian, në pikëpamje të bashkëpunimit ndërkombëtar në hetimet penale e financiare dhe njohjen e ndërsjellë si dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, procedura për konfiskim ka pësuar ndryshime dhe modifikime. Mirëpo, ato që janë me rëndësi të posaçme, e janë në drejtim të rregullimit të përfitimit të konfiskuar pronësor dhe të sendeve, si dhe menaxhim të mëtejshëm me të njëjtat, por edhe rregullim të çështjes së procedurës për konfiskim të përkohshëm dhe të përhershëm, janë të parapara me miratimin e Ligjit për menaxhim me pronën e konfiskuar, përfitimit nga prona dhe sendet e konfiskuara në procedurën penale dhe kundërvajtëse (LMPK) si dhe me formimin e Agjencisë për menaxhim me pronën e konfiskuar, përfitimit nga prona dhe sendet e konfiskuara në procedurën penale dhe kundërvajtëse (Agjencia). Në mënyrë shtesë, me fuqizimin e pozitës së prokurorëve publik në procedurën penale, gjatë aplikimit të ndryshimit në sistemin nga inkuizitor në akuzues në ndryshimet e atëhershme të LPP, prokurorët si palë në procedurën fitojnë rol shumë më të pavarur dhe janë vendosur në pozitën e dominus litis gjatë udhëheqjes me hetimet. Nga kjo rezulton edhe mundësia për kontribut më të madh dhe pozicionim të masës konfiskim si masë kyç në luftën me krimin e organizuar dhe me korrupsionin.

<sup>1</sup> m-r Todor Vitllarov, prof. d-r Gordan Kallajxhiev, d-r Miodrag Llaboviq, d-r Trpe Stojanovski, Analizë sistemore e kornizës ligjore dhe bashkëpunimi midis institucioneve kompetente në luftën kundër krimit të organizuar, Fondacioni Shoqëria e hapur – Maqedoni, Shkup, 2005, fq.20

## Konfiskimi në kodin penal

Kodi penal i RMV në mënyrë të alternuar përdor tre nocione kur bëhet fjalë për marrje të pronës së përfituar në mënyrë të kundërligjshme ose të përfitimit nga prona të fituar në atë mënyrë – “konfiskim”, “sekuestrim” dhe “marrje”. Me këtë rast, këto nocione as që janë të definuara e as të diferencuara në mënyrë përkatëse në vetë tekstin ligjor, përkatësisht në nenin i cili i rregullon nocionet ligjore dhe domethënien e tyre. Ajo që e rregullon kjo pjesë e ligjit është definimi dhe përkufizimi i nocioneve “pronë” dhe “sende”, nga e cila mund të konkludohet se intenca e ligjdhënësit ka qenë që marrja e sendeve<sup>2</sup> të bëjë vetëm me sende të luajtshme që janë shfrytëzuara, të dedikuara për tu shfrytëzuar ose të cilat janë krijuar me kryerjen e veprës penale, kështu që kjo dispozitë nuk paraqet konfiskim të përfitimit pronësor në kuptimin e vërtetë.

Prapëseprapë, dispozitat ligjore e ndjekin kornizën e vendosur në suaza ndërkombëtare, kështu që konfiskimi në KP është i përcaktuar si masë e veçantë me të cilën, në pajtim me kushtet ligjore, merret përfitimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë që është fituar me realizimin e veprës penale. Kjo e klasifikon konfiskimin si masë të posaçme ndëshkimore juridike e cila është pasojë e vetë veprës penale dhe nuk është e ndërlidhur me kryerësin, e as me përgjegjësinë penale. Në atë drejtim, në pajtim me dispozitat vendore, konfiskimi mund të aplikohet edhe ndaj personave të tretë që nuk janë të ndërlidhur me vetë veprën penale përmes së cilës është përfituar prona, dhe e cila mund të aplikohet edhe në kushte kur ekzistojnë pengesa faktike ose juridike për përndjekje penale, siç është ekzistimi i imunitetit, amnistisë, vjetërsimit e kështu me radhë. Pikërisht edhe nga këto dispozita mund të konfirmohet konstatimi se konfiskimi nuk

është ndëshkim, por ka natyrë retributive. Mbështetje për janë edhe vetë parimet të drejtësisë dhe të ligjshmërisë sipas të cilave asnjë e drejtë nuk mund të fitohet pa bazë ligjore ose tjetër juridike, dhe për këtë shkak, me konfiskimin e pronës së përfituar në mënyrë joligjore nuk preken të drejtat e askujt, por përkundrazi, bëhet kthyerje në gjendjen paraprake që ka ekzistuar para kryerjes së veprës penale, kështu që parimet e drejtësisë dhe ligjshmërisë në esencë paraqesin edhe bazë ligjore për shqiptim dhe aplikim të masës konfiskim.

KP i vendos bazat për konfiskim, kështu që sipas nenit 97 përfitimi i tërthortë ose i drejtpërdrejtë pronësor i fituar me vepër penale, do të konfiskohet me vendim gjyqësor me të cilin është përcaktuar kryerja e veprës penale, do të konfiskohet me vendim gjyqësor me të cilin është konstatuar kryerja e veprës penale, si dhe në procedurë të posaçme në rastet kur nuk është e mundur të ngritet procedurë penale 2. Nga kjo, është e pashmangshme që të konstatohet se në Republikën e Maqedonisë së Veriut shqiptimi i masës konfiskim është e ndërlidhur me procedurën penale, ndërsa dispozitat të cilat e rregullojnë këtë masë, gjykatën e identifikojnë si organ të vetmin i cili mund të shqiptojë të njëjtën.

Për të miratuar vendim për konfiskim, gjykata duhet të jetë e bindur se është kryer vepër penale, madje edhe në rastet kur ekzistojnë pengesa faktike dhe juridike për ngritje të procedurës penale. Kjo praktikë mund të shkaktojë vështirësi te prokuroria në procesin e grumbullimit të dëshmive në lidhje me ekzistimin e veprës penale, gjë e cila mund të jetë e vështirë për shumë shkaqe, e posaçërisht për

<sup>2</sup> Në kuptim të nenit 100-a nga KP

shkak të kalimit të kohës. Nga ana tjetër, kjo e ngre pyetjen se deri në cilën shkallë gjykata duhet të jetë e bindur se është kryer veprë penale në këto raste – vallë a jashtë nga dyshimi racional ose vallë a ka qenë dyshimi racional i mjaftueshëm? Për shkak të kësaj, nevojitet edhe mekanizëm përkatës mbrojtës dhe avancimi i mëtejme i ligjeve vendore për tu shmangur keqpërdorimi potencial i konfiskimit si sanksion i fshehur në raste kur për shkaqe juridike ose juridike nuk mund të ngritet procedurë penale. Në këtë kontekst, është posaçërisht me rëndësi që të shqyrtohet praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut (GJEDNJ), e cila pa marrë parasysh se miraton qasje kazualiteti, gjë e cila sjell te praktika dhe standardet që nuk janë të vendosura në mënyrë të mjaftueshme në lidhje me konfiskimin, prapëseparë dha disa përgjigje në disa pyetje. Kështu, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6 (e drejta për fer gjykim) dhe neni 7 (pa ndëshkim – pa ligj), si dhe neni 1 nga protokollin 1 (e drejta për gëzimin e qetë të pronës) në raste kur është e shqiptuar masa e konfiskimit pa vendim paraprak gjyqësor për fajin, posaçërisht në vendet të cilat nuk kanë aplikuar in rem konfiskim (konfiskim civil), prapëseparë Gjykata vëren edhe se nuk ka nevojë për vendim gjyqësor penal në kuptimin formal, gjë e cila do të thotë se gjykatat e vendit duhet të bëjnë së paku deklarament formal për përgjegjësinë penale, siç janë vrojtimi dhe arsyetimi për ekzistimin e elementeve dhe të dëshmimeve në lidhje me veprën e supozuar penale<sup>3</sup>.

Mirëpo, ashtu siç tanimë u theksua, krahas bazave të vendosura me avancimin e tekstit ligjor, në KP

u implementua edhe mundësia për konfiskim të pronës e cila vetvetiu drejtpërdrejtë nuk është fryt i veprës penale, por është pronë në të cilën është transformuar ose është përzier përfitimi jolegal ose është pronë që është prodhim i rritjes së mëtejme të pronës së përfituar në mënyrë jolegale, përkatësisht kjo është konfiskim i tërthortë. Ky lloj i konfiskimit parashikon mundësi parashikon mundësi që i njëjti tu shqiptohet anëtarëve të familjes të kryerësit, si dhe cilit do qoftë person të tretë, nëse të njëjtit nuk arrijnë të dëshmojnë se për pronën e kaluar në emrin e tyre kanë dhënë zhdëmtim të caktuar. Si rrjedhojë, personat që disponojnë me pronën e cila është lëndë e konfiskimit kanë obligim të dëshmojnë se e njëjta është fituar në mënyrë legale, përkatësisht se për të kanë dhënë zhdëmtim përkatës, me çka në mënyrë efektive është bërë transferimi i ngarkesës së dëshmimit. Kjo do të thotë se për tu përcaktuar nëse një pronë e caktuar duhet të konfiskohet, prokurori nuk është i obliguar të dëshmojë jashtë nga dyshimi racional se prona është përfituar në mënyrë jolegale, ndërsa personi i cili pohon se prona është fituar në mënyrë legale ka obligim që të njëjtën ta dëshmojë. Kjo nënkupton se personat në të cilat bie pesha e dëshmimit të prejardhjes legale të pronës, nuk duhet patjetër të akuzohet as që është e nevojshme lidhja e tyre me veprën penale. “Prapëseparë, ata i gëzojnë të gjitha garancitë procesuale të subjektit të procedurës penale, e kështu disponojnë me të gjitha të drejtat dhe autorizimet për ta kundërshtuar propozimin për konfiskim, si dhe të përcaktimit të faktit se prona me të cilën disponojnë ka prejardhje kriminale”<sup>4</sup>.

<sup>3</sup> G.I.E.M. S.R.L. and Others v. Italy, no 1828/06, e qasshme në: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-184525%22%5D%7D>

<sup>4</sup> Kambovski Vllado, Kallajxhiev Gordan, Zikov Sterjo, Mitreska Iskra, Konfiskimi dhe masa të përkohshme: Harmonizimi i drejtës vendore me standardet ndërkombëtare, Revista maqedonase për të drejtën ndëshkuese dhe kriminologji, viti 13, nr. 3 fq. 258.

Me aplikimin e institutit konfiskim i zgjeruar në legjislativin vendor, në tërësi janë të implementuara dispozitat e vendimit Kornizë të Këshillit të Evropës 2005/212/JHA për konfiskim të hyrave, me çka është bërë harmonizimi i legjislativit të vendit me legjislativin e Unionit Evropian në pikëpamje të ngrirjes dhe ngrirjes së pronës së përfitur në mënyrë jolegale. Konfiskimi i zgjeruara ka për qëllim që të mundësojë të aplikohet supozim sipas të cilit përfitimi pronësor e kryerësit ose të personave të tretë, është fituar në periudhë të caktuar kohore dhe se buron nga aktivitet kriminal, dhe si e tillë ka mundësi të konfiskohet nëse të njëjtit nuk mund ta dëshmojnë prejardhjen ligjore të pronës. Periudha kohore në rastin konkret theksohet për tu mundësuar konfiskimi i pronës së fituar edhe para kryerjes eventuale të veprës, në raste kur gjykata ka bindje të bazuara se prona i tejkalon të ardhurat ligjore të kryerësit dhe se buron nga një vepër e tillë.

Ajo që është specifike, por edhe praktikisht nga aspekti i implementimit të kësaj mase është fakti se e njëjta, e posaçërisht kur bëhet fjalë për institutin konfiskim i zgjeruar, e lehtëson dëshmimin dhe marrjen e pronës së përfitur në mënyrë jolegale në mënyrën që kontribuon në uljen e standardeve për dëshmim dhe me transferim shtesë të ngarkesës për dëshmim të legalitetit të të ardhurave mbi kryerësin e veprës së caktuar penale. Ashtu, në pajtim me dispozitat e parapara me Kodin penal, ky lloj konfiskimi aplikohet mbi kryerësin të veprave të caktuara penale, përkatësisht të veprës për të cilën është paraparë dënim me burg prej më së paku 4 vite, të kryer në kuadër të bashkimit kriminal me të cilin

realizohet përfitim pronësor si dhe për vepër penale në lidhje me terrorizmin, rrezikimit terrorist të rendit kushtetues dhe të sigurisë, për organizim terrorist, terrorizëm, financim të terrorizmit dhe terrorizëm ndërkombëtar, për të cilat është paraparë dënim prej më së paku 5 vite burg ose dënim më të rëndë, madje nëse është e ndërlidhur me veprën penale larje e parave për të cilën është përshkruar dënim me burg prej më së paku 4 vite. Në këto raste do të konfiskohet prona e fituar në periudhën kohore para dënimit që e përcakton sipas rrethanave të rastit, por periudhë jo më e gjatë se pesë vite para kryerjes së veprës, kur në sajë të të gjitha rrethanave gjykata është ka bindje të bazuar se prona i tejkalon të ardhurat ligjore të kryerësit dhe që rrjedh nga vepra e tillë<sup>5</sup>.

Aplikimi i institutit konfiskim i zgjeruar me siguri është plotësim i rëndësishëm i Kodit penal, posaçërisht për shkak se aplikon ndryshimin e ngarkesës për dëshmim dhe jo vetëm për personat e tretë por edhe për të akuzuarin. Prapëseprapë, ndryshimi i ngarkesës së dëshmimit është vetëm në raport me përfitimin joligjor, e jo edhe në lidhje me fajin e të akuzuarit, por e njëjta është vetëm e pjesshme, gjë e cila nënkupton se prokurori patjetër duhet të sigurojë dëshmi që do ta bindin gjykatën se i akuzuari, i dënuar për disa nga veprat e parapara penale në nenin 98-a, nuk ka mundur ta përfitojë sendin në fjalë në mënyrë ligjore.

Qartësia e pamjaftueshme në dispozitat ligjore ngre çështje të caktuara, e posaçërisht në raport me standardin e dëshmimit. Duke e ndjekur formulimin e saktë të ligjit, prona e fituar para kryerjes së veprës

---

<sup>5</sup> Кривичен законик на Република Македонија („Службен весник на Република Македонија“ број 37/96, 80/99, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 115/14, 132/14, 160/14, 199/14, 196/15, 226/15 и 97/17)

penale do të konfiskohen kur gjykata është “e bindur mirë” se prona i tejkalon të ardhurat ligjore të të akuzuarit, ndërsa e njëjta pronë do të konfiskohet nga persona të tretë që nuk mund ta dëshmojnë prejardhjen juridike, me sigurim të dëshmime për kundër-kompensim. Në bazë të kësaj, mund të konstatohet se ky formulim imponon dy standarde të ndryshme për të dëshmuar nga i akuzuari dhe nga personat e treta, përkatësisht, përderisa personat e treta patjetër duhet të dëshmojnë se pronën konkrete e kanë fituar në mënyrë ligjore me sigurim të kundër-kompensimit me vlerë përkatëse, e kur bëhet fjalë për të akuzuarin, prokurori publik është ai që duhet ta bind gjykatën se prona në fjalë nuk ka mund të përfitohet në mënyrë ligjore. Krahas kësaj, në mënyrë shtesë vështirëson rrethana që KP e përdor nocionin “e bindur mirë” në vend të nocioneve tanimë të miratuara dhe të njohura në ligjet e vendit, siç janë “dyshim racional” ose “jashtë nga dyshimi racional”, duke kontribuar kështu edhe më shumë për konfuzitetin në lidhje me standardin e dëshmitit të pranuar për konfiskim të vazhduar. Nga ana tjetër, disa autorë pohojnë se nocioni “e bindur mirë” duhet të shpjegohet si dyshim racional se prona është fituar me aktivitete kriminale, ndërsa në ngarkesë e të akuzuarit është ta mënjanojë dyshimin, për ta shmangur konfiskimin e zgjeruar. Autorët prapëseprapë pranojnë se duhet të bëhet intervenim përkatës në KP për tu përmirësuar siguria juridike<sup>6</sup>.

Në pikëpamje të konfiskimit të zgjeruar, KP vetëm e zbaton terminologjinë e përdorur në Vendimin Kornizë të Këshillit të Unionit Evropian nga viti 2005, e nga kjo në dispozitat që e rregullojnë konfiskimin e zgjeruar paraqiten nocione siç janë “rrethanat e

rastit” dhe “bindja me bazë e gjykatës”, e të njëjtat nuk janë përpunuar për tu ofruar definicion konkret për atë se kur mund të konsiderohet se ka bazë bindja e gjykatës së gjykatës për tra shqiptuar masën konfiskim i zgjeruar, si dhe kur mund të konsiderohet se rrethanat e rastit atë e lejojnë. Megjithëse ideja e një formulimi të përcaktuar në mënyrë rigoroze në Vendimin Kornizë është që të lërë hapësirë për legjislacionet kombëtare për të rregulluar këtë çështje në detaje, ashtu siç konsiderojnë se është mënyra më përkatëse, posaçërisht nëse merret parasysh llojllojshmëria e sistemeve juridike dhe e traditës juridike në shtetet e UE, ndërsa ideja e ligjvënësimit në Republikës së Maqedonisë së Veriut është promovimi i parimit të vlerësimit të lirë të dëshmime dhe autonomisë së gjykatës në vendimmarrjen, prapëseprapë formulimi i tillë në ligjin mund të sjell në praktikë të pa baraspeshuar gjyqësore, si dhe shkelje serioze të të drejtave themelore të njeriut me zbatimin e zhdrejtë të konfiskimit të zgjeruar. Në këtë drejtim, me rëndësi është të theksohet se edhe Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut nuk ka dhënë përgjigje të fortë në të gjitha pyetjet që burojnë nga aplikimi i nga zbatimi i konfiskimit, gjë e cila e vështirëson definimin e kornizës së precize për vlerësim të arsyeshmërisë së aplikim it të konfiskimit. “Në këtë kontekst duhet ti kushtohet vëmendje procedurës në të cilën në praktikë zbatohet zgjidhja e këtillë, për shkak të rrezikut potencial nga shkelja si të standardeve vendore ashtu edhe të atyre ndërkombëtare për mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut siç është mbrojtja e pronësisë”<sup>7</sup>. Konfiskimi automatik i sendeve që shfrytëzohen për ekzekutimin e veprave të caktuara penale mund të jetë problematik nga aspekti i praktikës gjyqësore të Gjykatës

---

<sup>6</sup> Kambovski Vlado PhD., Misoski Boban PhD.: Material and procedural legal aspects of confiscation of property and property gains, Research within the project “Reform of criminal law and respect for human rights - preparations for consistent implementation of the new LCP”, Skopje, October 2009

<sup>7</sup> Kambovski, Kallajxhiev, Sterjo Zikov, Iskra Mitreska, Konfiskim dhe masa të përkohshme: Harmonizimi i të drejtës vendore me standardet ndërkombëtare, Revista maqedonase për të drejtën ndëshkuese dhe kriminologji, viti 13, nr. 3



cilën është ngritur akuza. Të njëjtat këto parime kanë të bëjnë me cilën do qoftë komponentë të procedurës penale, gjë e cila do të thotë prokurori gjithashtu është i detyruar që të grumbullojë dëshmi dhe të propozojë masa të përkohshme si paraburgim, konfiskim të pronës, ngirje e përkohshme e pronës, konfiskim e kështu me radhë.

Në pajtim me dispozitat e parapara me Kodin penal, masa e konfiskimit shqiptohet në procedurën *in personam*, përkatësisht në procedurën penale e cila udhëhiqet kundër një personi të caktuar, ndërsa ligji mundëson që e njëjta të shqiptohet edhe në situatë kur ngritja e procedurës penale kundër një personi të caktuar nuk është e mundur për shkak të pengesave faktike ose juridike. Në dispozitat në të cilat rregullohet aplikimi i kësaj mase, njëlloj edhe si te KP, LPP përdor më shumë nocione që kanë të bëjnë me marrjen e përfitimit nga prona të ndërlidhur me ose që buron nga vepër penale, siç është: “konfiskim”, “marrje” dhe “sekuestrim”. Edhe përkundër tendencës së dukshme së ligjvënësit që të bëjë diferencim përkatës gjatë përdorimit të nocioneve të lartpërmendura, as në ligjin material e as në atë procesuale nuk janë paraparë definicione konkrete ose përkufizim i qartë midis nocioneve që kanë të bëjnë me sekuestrimin e përhershëm të përfitimit kundër-ligjor pronësor.

Marrja në kohë e masave për sigurimin e pronës së përfituar në mënyrë joligjore, që në fazat e hershme të procedurës, në praktikë u tregua si thelbësore në luftën kundër krimit të organizuar, por edhe kundër krimit të motivuar financiarisht. Prandaj, duke pasur parasysh se në praktikë hetimi penal është pothuajse pa përjashtim më e shpejtë se hetimi financiar, e shpesh herë të dhënat e detajuara për pronën dhe përfitimin e fituar me vepër penale mund të merren mjaft më vonë pas parashtrimit të akuzës,

legjislativi vendor parashikon një varg të masave në pajtim me të cilat është mundësuar sekuestrimi i përkohshëm, përkatësisht ngirje e pronës ose të përfitimit pronësor. Në sajë të të njëjtës, përkatësisht në sajë të dispozitave të parapara në ligjin procesuale gjykata në cilën do qoftë gjatë procedurës penale, me kërkesë të prokurorit publik mund të sjellë masë të përkohshme – marrje të pronës ose të sendeve të cilat sipas Kodit penal duhet të merren, masë të sekuestrimin ose masë tjetër të nevojshme për t’ju penguar shfrytëzimi, tjetërsimi ose disponimi me atë pronë ose sende<sup>10</sup>. Dispozita e këtillë mundëson që të mos zvarritet përndjekja për shkak të hetimit financiar, e as të komprometohet cilësia e hetimit financiar, i cili realizohet paralelisht me hetimin penal. Të gjitha këto masa për marrje të pronës dhe të përfitimit nga prona për shkak të sigurimit shqiptohen me vendim gjyqësor të miratuar me propozim të prokurorit publik, ndërsa të njëjtat mund të shqiptohen edhe ndaj personave të treta

Në sajë të veprimeve të ndërmarra paraprakisht nga prokurori publik, e në pajtim me dispozitat e përmendura më lartë për sekuestrim të përkohshëm të sendeve, pronës dhe përfitimit nga prona të fituara me vepër penale, në procedurën penale bëhet përcaktimi i prejardhjes së tyre joligjore<sup>11</sup>. Me këtë rast, prokurori publik është i obliguar që të grumbullojë dhe propozojë dëshmi të cilat janë të nevojshme për përcaktim të lartësisë së vlerës së pronës dhe të përfitimit nga prona të fituara me vepër penale, për të cilën gjë në dispozicion e ka edhe autorizimin që të kërkojë të dhëna përkatëse nga organet shtetërore, institucionet financiare, personat juridik dhe fizik. Procedura për konfiskim në R e Maqedonisë së Veriut ofron garancione të caktuara procesuale për personat kundër pronës së të cilëve është parashtruar kërkesë për konfiskim, por të njëjtat nuk janë të plota. Kjo

<sup>10</sup> Ligji për procedure penale i Republikës së Maqedonisë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 150/10, 100/12 dhe 142/16)

<sup>11</sup> Закон за кривичната постапка на Република Македонија („Службен весник на Република Македонија” број 150/10, 100/12 и 142/16), член 530



kryesisht ka të bëjë me përshtatjen jo-përkatëse dhe jo të plotë të dispozitave që e rregullojnë procedurën për konfiskim, me sistemin e ri të aplikuar adversijal të procedurës penale.

Sipas LPP, sekuestrimi i përfitimit nga prona mund të shqiptohet në procedurë me të cilën i akuzuari shpallet fajtor, me vendim për vërejtje gjyqësore, vendim për zbatim të masës edukative si dhe vendim me të cilin shqiptohet masa siguri. Gjithashtu, gjykata mund të sjell edhe masë për konfiskim edhe në rast kur do të sjell vendim për ndërprerje të procedurës sipas rasteve të përcaktuara me ligj, në të cilën mund të sjell vendim edhe për konfiskim nga një person të tretë, por është lënë edhe mundësia edhe mundësia për shqiptim të konfiskimit në rastin kur për shkak të

pengesave faktike ose juridike nuk ka mundësi që të udhëhiqet procedurë penale. Konfiskimi, teoretikisht është i mundur edhe pa dënimin penal në situatat kur nuk është e mundur që të realizohet procedurë penale dhe kur me dëshmi të mjaftueshme është konstatuar se ka të bëjë me pronë të fituar me kryerje të veprës penale ose është e përdorur për kryerje të një veprë penale. Prapëseparë, këto dispozita nuk janë të përpunuara në mënyrë përkatëse, kështu që LPP nuk ofron sqarime shtesë në pikëpamje të fillimit dhe të rrjedhës së procedurës, rregullat procesuale dhe garancitë për palët në procedurën, e as që në çfarë do qoftë mënyre e rregullon këtë procedurë të posaçme për konfiskim në rastet kur nuk është e mundur ngritja ose përfundimi i procedurës penale, kështu që e njëjta në praktikë është e pa përdorshme.

## Zbatimi praktik i masës konfiskim

—

Për nevojat e këtij dokumenti për politikën publike u analizuan të dhënat me të cilat disponon Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", e të cilat paraprakisht i kishte siguruar në bazën e vet të të dhënave e të njëjtat kanë të bëjnë për të dhëna nga këqyrjet e zbatuara në lëndët e kryera fuqiplote gjyqësore para Gjykatës themelore penale në Shkup, si dhe të dhëna të qasshme publike dhe qasje në informacione me karakter publik. Të dhënat janë të ekstraktuara nga


26 lëndë të përfunduara penale në të cilat është përcaktuar masa e konfiskimit, si dhe nga të dhënat statistikore të Gjykatës Themelore penale Shkup, Prokuroria penale për përndjekje të krimit të organizuar dhe të korrupsionit, Drejtoria për polici financiare dhe Agjencia për menaxhim me pronë të konfiskuar, përfitim nga prona dhe sende të sekuestruara në procedurën penale dhe kundërvajtëse. Këtu me rëndësi është të përmendet se nuk ekziston një

sistem i integruara dhe metodologji e baraspeshuar për grumbullim të të dhënave, e pa marrë parasysh që në kuadër të Prokurorisë publike është themeluar Zyra për kthyerje të pronës (Asset Recovery Office), prapëseprapë të dhënat në raport me zbatimin e masës së konfiskimit janë shpërndarë në më tepër institucione të ndryshme. Këto institucione (me përjashtim të Agjencisë për menaxhim me pronën e konfiskuar) nuk janë të ndërlidhura me kurrfarë dispozita të posaçme në pikëpamje të llojit dhe vëllimit të të dhënave të cilat, për punën e tyre, duhet ti grumbullojnë dhe përpunojnë, sepse në praktikë të njëjtat grumbullojnë jashtëzakonisht pak informacione që kanë të bëjnë me punën e tyre operative në lidhje me zbatimin praktik të konfiskimit. Si pasojë e kësaj, institucionet nuk kanë qasje të koordinuar në mënyrën dhe metodologjinë për grumbullim dhe përpunim të të gjitha të dhënave, për shkak të cilës është vështirë të analizohen të gjitha aspektet e zbatimit të konfiskimit, posaçërisht në

pikëpamje të hetimeve penale dhe financiare, ndërsa metodologjia e pa barazuar, në të njëjtën kohë e pamundëson edhe ndjekjen përkatëse të zbatimit të konfiskimit dhe sigurimin e përkohshëm të sendeve në të njëjtin rast për ekzekutimin e konfiskimit përmes të gjitha fazave të procedurës (procedura hetimore, procedura gjyqësore, procedura për zbatim të konfiskimit dhe procedurë për shitje ose shfrytëzim të pronës së konfiskuar).

Nga të dhënat statistikore të Drejtorisë për polici financiare mund të vërehet se pa marrë parasysh se ekziston një trend i caktuar i rritjes së numrit të paraqitjeve penale të parashtruara nga ana e këtij institucioni, numri i hetimeve financiare me të cilat janë të përfshira vepra penale të ndërlidhura me korrupsionin mbetet relativisht konstant ose mesatarisht rreth 20% nga numri i tërësishëm i hetimeve financiare<sup>12</sup>.

### Hetime financiare të Drejtorisë për polici financiare



<sup>12</sup> <<https://finpol.gov.mk/mk/statisticki-podatoci>>

Prapëseprapë, ajo që është mbresëlënëse nga këto raporte të Drejtorisë për polici financiare është ajo që bëhet fjalë për paraqitjet e parashtruara penale në prokurorinë publike, pas hetimit e zbatuara të Drejtorisë. Kompletimi i hetimit financiar, para se në përgjithësi të fillojë procedura penale, është procedim jo i zakonit sepse e njëjta e sjell hetimin financiar në nivel të hetimit penal për kri të kryer financiar. Në këtë mënyrë, hetim i financiar mund ti detektojë vetëm të ardhurat e drejtpërdrejta nga kryerja e veprës penale, gjë e cila korrespondon me përfaqësimin e lartë të veprës penale “fshetje tatimore” në mesatare prej më së paku mbi 40%, ose, ndërkaq, të detektojë parregullsi themelore në punën financiare që rezultojnë me përndjekje penale, gjë e cila korrespondon me përfshirjen e lartë të veprës penale “falsifikim ose asgjësim i librave afariste”, e cila është e përfaqësuar mesatarisht nën 20% nga të gjitha paraqitjet penale të parashtruara nga Drejtoria, por jo edhe ta zbulojë përfitimin e drejtpërdrejtë pronësor, si dhe përfitim nga prona e cila është rezultat e shumëzimit të mëtejme dhe të transferimit të pronës së përfituar në mënyrë joligjore, e as ti detektojë të gjitha personat e involvuar që mund të përfitojnë dobi joligjore nga vepra penale. Kjo e vë në pah nevojën për qasje të koordinuar dhe strategji për zbatim simuluan të hetimit penal dhe financiar, me çka do të mund që në mënyrë të suksesshme të targetohet e tërë prona që është përfituar në mënyrë joligjore, si dhe të pamundësohet fshetje eventuale dhe transferimi ose transformimi i pronës së përfituar në mënyrë joligjore

Në drejtim të kësaj, PTHP PKPK dhe gjykata Themelore penale Shkup nuk posedojnë të dhëna për numrin e të dhënave të parashtruara për marrje të përkohshme të pronës për shkak të sigurimit, përkatësisht ngrirjes së një pjese të pronës për të cilën ekziston dyshim i bazuar se buron nga burime

jolegale, për tu mundësuar ekzekutimi i mëtejme i masës eventualisht të shqiptuar të konfiskimit. Në mënyrë shtesë, të njëjtat nuk posedojnë informacione për numrin e kërkesave për konfiskim të parashtruara nga ana e prokurorëve publik, me çka evaluimi i performancës së tyre në raport me e zbatimit të konfiskimit si masë për parandalim të të korrupsionit tani për tani mbetet i pamundur. Nga ato të dhëna të cilat i posedon Gjkata Themelore penale, mund të vërehet se nga viti 2015 deri në vitin 2019 janë shqiptuar 10 vendime të pa plotfuqishme dhe 35 vendime të plotfuqishme të konfiskimit, nga të cilat në pajtim statistikës së gjykatës 20 janë shqiptuar në kuadër të Departamentit për krim të organizuar dhe korrupsion që është kompetent të procedojë në sajë të akuzave të PTHP PKPK. Nga të gjitha këto 45 masa të konfiskimit, vetëm 5 kanë të bëjnë me vepra penale të ndërlidhura me korrupsionin nga Kapitulli XXX të Kodit penal, nga të cilat 3 janë në lëndët nga kompetenca e PTHP PKPK, përkatësisht të lëndëve të ndërlidhura me korrupsionin e lartë<sup>13</sup>.

Siç u theksua paraprakisht, mungesa e definimit preciz të nocionit dhe institutit të konfiskimit, parasupozon edhe mungesë të subjektit kompetent i cili të njëjtin do ta kishte propozuar. Më saktë, dispozitat e LPP parashikojnë se gjykata mund, në çdo kohë gjatë procedurës penale, me kërkesë të prokurorit publik të sjell masë të përkohshme marrje të pronës ose të sendeve të cilat sipas Kodit penal duhet të merren, masa e sekuestrimit ose masë tjetër e nevojshme e përkohshme për tu penguar shfrytëzimi, tjetërsimi ose disponimi me atë pronë ose me ato sende. Këto kërkesa nga ana e prokurorisë mund të parashtrihen në fillimin dhe në vazhden e procedurës paraprake, e për të njëjtat vendos gjykatës i procedurës paraprake, përkatësisht gjykatës i cili debaton për lëndën e ngritjes së akuzës. Por, kjo është rast kur bëhet fjalë

---

<sup>13</sup> Raport vjetor për punën e Prokurorisë themelore publike për ndjekje të krimit të organizuar dhe të korrupsionit për vitin 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019, si dhe përgjigje për kërkesat për qasje në informacione me karakter publik të dërguara në Gjykatën themelore Shkup.

për sekuestrim të përkohshëm, përfitim nga prona ose nga sendet, mirëpo në nenin konkret të LPP që kanë të bëjnë me këtë me këtë, nuk është paraparë vendim edhe për masën konfiskim, kështu që praktikuesit shumë shpesh janë në hamendje për atë se kush e propozon masën e konfiskimit, përkatësisht nëse gjykata mund ta shqiptojë me vetiniciativë dhe pa kërkesë të prokurorit ose ajo është obligim i prokurorit publik. Kjo është diçka që duhet të përkufizohet dhe më shumë se e qartë, nëse merret parasysh fryma e normave nga ligji, e posaçërisht me ndryshimin e karakterit të procedurës penale nga neoinkvizitore (e përzier) në procedurë tërësisht e palëve, që vetvetiu e ndryshon edhe mënyrën, përkatësisht ngarkesën për hetim dhe grumbullim të dëshmive. Për dallim nga më herët, tani LPP e ngarkon prokurorin publik që ai të grumbullojë dëshmi të ndërlidhura me përcaktimin e pronës dhe të përfitimit nga prona, e nga kjo logjik është edhe supozimi se i njëjti duhet ti parashtrojë gjykatës edhe kërkesë për përcaktim të kësaj mase.

Por, nga të dhënat e përpunuara gjatë këqyrjeve të zbatuara, mund të vërehet pikërisht e kundërta. Në të vërtetë, nga gjithsej 26 lëndë në të cilat është realizuar këqyrja, në të cilat është shqiptuar masa e konfiskimit, në 21 prej tyre prokurori publik nuk ka kërkuar zbatim të masës konfiskim, ndërsa 1 lëndë ka përfunduar me urdhërese ndëshkimi, përkatësisht pa zbatimin e procedurës, ndërsa në dy lëndë të akuzuarit janë që obliguar ta kthejnë shumën e përfituar në mënyrë jolegale në një periudhë të përcaktuar kohore. Kjo padyshim sjell në konkluzën se prokuroria publike ende "mbështetet" në gjykatën kur bëhet fjalë për shqiptim të kësaj mase dhe lë që vetë të vlerësojë kur do të duhej të shqiptohet e njëjta e kur jo. Gjendja e këtillë mund posaçërisht të

jetë problematike nga aspekti i ekzekutimit të masës konfiskim, sepse mungesa e kërkesës për konfiskim vetvetiu do të thotë edhe mungesë e propozimit për përcaktim të masës për sekuestrimit të përkohshëm të pronës ose të përfitimit nga prona për shkak të sigurimit, që mund të vjen vetëm me propozim të prokurorit publik. Mungesa e aplikimit të ngrirjes së përkohshme të pronës në procedurat, si rezultat i pasivitetit të prokurorëve publik mundëson diskonim të lirshëm me pronën e përfituar në mënyrë joligjore gjatë kohës kur zgjat procedura, gjë e cila mund të sjell në tjetërsimin e saj të plotë ose në fshehjen para se të kryhet konfiskimi. Në këtë situatë, kur Agjencioni për prona të konfiskuar nuk do të mund ta gjejë pronën konkrete për ta ekzekutuar masën mbi pronën e personit të dënuar, e njëjta nuk ka kompetence të zbatojë hetim për zbulimin e pronës së fshehur, e as ka kompetence të zbatojë hetim që vetë të zgjedh pronë tjetër që do të ishte konfiskuar, sepse atë e përcakton gjykata me vendimin gjyqësor. Nga ana tjetër, ndërkaq, për organet e përndjekjes kjo do të kishte qenë punë tanimë e gjykuar dhe të njëjtit nuk do të kishin mund të iniciojnë hetim shtesë për gjetje të pronës, e as gjykata mund të sjell vendim të ri që ka të bëjë me lëndën e njëjtë tanimë të gjykuar, me çka shqiptimi i konfiskimit do të kishte qenë vetëm provizor dhe pa efekt.

Kur, ndërkaq, bëhet fjalë për dëmin e shkaktuar me veprat penale, përkatësisht lartësinë e pronës së fituar në mënyrë joligjore me veprat penale, përkatësisht lartësia e pronës së fituar në mënyrë joligjore sipas akuzës në lëndët që ishin objekt i analizës, lartësitë e shumave variojnë nga 500 000 denarë deri në 10 000 000 denarë, ndërsa lëndë e konfiskimit në këto raste krahas mjeteve në para janë edhe sende të

tjera të luajtshme, ndërsa në një nga rastet është konfiskuar edhe pronë e paluajtshme. Në mënyrë shtesë, vëmendjen e kthyen dy lëndë individuale në të cilat prokurori ka kërkuar konfiskim, por nuk e ka përcaktuar dëmin e shkaktuar në aktin e akuzës gjatë parashtrimit të tij, ndërsa lëndët janë përfunduar me masë të shqiptuar nga gjykata. Kjo gjendje në masë të caktuar ka të bëjë me kufirin jo të qartë në mënyrë të mjaftueshme midis masës sekuestrim të sendeve që janë shfrytëzuar, të dedikuara ose që burojnë nga kryerja e veprës penale me masën konfiskim, kështu që jo rrallë në praktikë mund të vërehet se marrja e sendeve të shfrytëzuar, të dedikuara ose që burojnë nga kryerja e veprës penale evidentohet si masë e konfiskimit. Në këtë mënyrë, prokurori publik nuk ka obligim që ta dëshmojë vlerën e lëndës ose të pronës konkrete, por vetëm të dëshmojë se i njëjti është fituar me kryerje të veprës penale, gjë e cila sërish e vë në pah atë se kjo qasje mund të jetë efikase vetëm nëse bëhet fjalë për sekuestrim të sendit i cili në të njëjtën kohë është edhe dëshmi për veprën e kryer penale, si për shembull mjetet në para që janë dhënë ose janë pranuar si ryshfet, ose lartësia e tatimit të fshehur. Nga ana tjetër ndërkaq, nëse shihen edhe të dhënat e dërguara nga Agjencia për menaxhim me pronën e konfiskuar, mund të vërehet se edhe vetë konstatojnë se pjesa më e madhe e pronës së sekuestruar për periudhën prej vitit 2015 deri në vitin 2019 nuk i është vlerësuar vlera, mund të ngritet çështja nëse organet kompetente në shtetin kanë kapacitete përkatëse për të realizuar ekspertiza financiare, hetime dhe përcaktim të vlerës së pronës së tërësishme të sekuestruar ose të pronës për të cilën ekziston bazë që të jetë lëndë e konfiskimit? Prapëseprapë, ajo që është interesante, ndërsa në kontekst të problematikës së përmendur paraprisht me hetimet financiare dhe sjellja e tyre

në hetime penale për krim të kryer ekonomik, e ajo është që lartësia e masës së shqiptuar të konfiskimit pothuajse pa përjashtim korrespondon me masën dëmin e shkaktuar, përkatësisht me lartësinë e pronës së fituar në mënyrë joligjore me vepër penale. Kjo e vë në pah atë se në praktikë aspak edhe nuk ekzistojnë përpjekje për zbulim të shtimit të mëtejshëm të pronës jolegale me kryerje të veprës penale, transformimin e tij, fshehjen dhe integrimin në ekonominë legale.

Në pikëpamje të vlerësimit të sigurimit të të gjitha dëshmive të nevojshme për tu dëshmuar teoria e vendosur me akuzën, mund të shohim nëse vlera e pronës së fituar në mënyrë jolegale që është përcaktuar nga prokurori publik, korrespondon me shumën e shqiptuar me të cilën është paraparë konfiskimi, nga e cila në realitet konstatohet se në vetëm 10 lëndë korrespondon, ndërsa në 8 lëndë aspak nuk është përcaktuar lartësia e dëmit, përkatësisht prona e fituar në mënyrë jolegale në vetë akt-akuzën. Në këtë shtohen edhe 8 raste në të cilat lartësia fillimisht e vendosur për dëmin e bërë, përkatësisht lartësia e pronës së fituar në mënyrë joligjore dallon, përkatësisht është më e ulët nga shumata përfundimtare që është përcaktuar me vendimin për konfiskim. Kjo gjendje e tregon atë se gjatë ngritjes, përkatësisht parashtrimit të akuzave në gjykatë, prokurorët nuk i kanë përgatitur në tërësi të gjitha pretendimet dhe dëshmitë mbi të cilat i bazojnë akuzat, si dhe në faktin se i kushtohet shumë pak, më saktë vëmendje e pamjaftueshme hetimeve financiare, e posaçërisht koordinimin e tyre me hetimet penale. Në mungesë të të dhënave të tjera përmes të cilave mund të matet performanca e prokurorëve publik në pikëpamje të shfrytëzimit të masës konfiskim dhe asgjësim të krimit të motivuar me shkaqe financiare

dhe të korrupsionit, me të vërtetë brengos e dhëna se krahas asaj që konfiskimi shumë pak aplikohet, posaçërisht në rastet e ndërlidhura me korrupsionin, por edhe në këto pak raste ekziston qasje joserioze, posaçërisht në fazën e hetimit.

Kur bëhet fjalë për personat të cilët janë të përfshirë me vendimin për konfiskim, duke pasur parasysh se ligji parashikon konfiskim si nga kryerësi i veprës, ashtu edhe nga persona të tretë, në lëndët që u analizuan, vetëm nga një prej tyre është evidentuar se është shqiptuar konfiskim kundër një personi të tretë dhe në mënyrë shtesë edhe në një tjetër është kërkuar dhe është shqiptuar konfiskim si nga i akuzuari, ashtu edhe nga një person i tretë. Në vetëm dy lëndë, siç e theksuam paraprakisht, të akuzuarit janë të obliguar ta kthejnë pronën e fituar në mënyrë joligjore, e këtu bëhet fjalë për lëndë në të cilat prokurori publik as që ka kërkuar konfiskim, e as e ka përcaktuar dëmin në vetë akuzën, si dhe lëndë në të cilën është proceduar në procedim të përshpejtuar dhe është shqiptuar urdhëresë ndëshkimore. Dispozita për konfiskim të pronës nga persona të tretë, të cilët nuk janë të akuzuar në procedurën është posaçërisht e rëndësishme, sepse mundëson targetim të posaçëm të çfarë do qoftë të ardhurave nga vepra penale me atë që e pamundëson fshehjen e saj dhe transferimin te persona të tretë, që mund të disponojnë me atë pronë duke mos ditur se e njëjta vjen nga një aktivitet joligjor.

Në këtë mënyrë dërgohet një mesazh absolut se krimi nuk paguhet, sepse masa e neutralizon çdo përfitim kriminal, që në realitet paraqet edhe motiv kryesor për kryerjen e krimit ekonomik dhe të korrupsionit. Me aplikimin jo-efektiv të kësaj mundësie, shtohet vetëm edhe një indikator i cili e vë në pah atë se lufta me korrupsionin zhvillohet vetëm përmes targetimit të të ardhurave të drejtpërdrejta nga veprat penale, duke mundësuar në atë mënyrë që një pjesë e pronës jolegale të mbetet e pa detektuar.

Në lëndët e analizuara hasëm në 24 vendime gjyqësore, 1 urdhëresë ndëshkimore dhe 1 procedurë të veçantë në të cilat është përcaktuar masa e konfiskimit, por në të cilat politika ndëshkimore shkon në drejtim të përdorimit dominant të ndëshkimit alternativ – dënim me kusht, përkatësisht në 16 nga lëndët është shqiptuar dënim me kusht dhe në atë në përqindje të madhe në kohëzgjatje prej 2 vitesh, e cila nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 4 vitesh nuk kryen veprë të re penale. Në 7 nga lëndët është përcaktuar dënim efektiv me burg në kohëzgjatje nga 1 deri 6 vite, me atë që shpesh herë dënim përcjellës me këtë është edhe dënimi me para e cila u përcaktohet të dënuarve. Në pajtim me politikën ndëshkimore në këto lëndë, mund të konkludojmë se konfiskimi me të vërtetë përdoret me të vërtetë rrallë, si dhe ajo se e njëjta rrallë ka të bëjë me vepra më të rënda penale dhe forma të korrupsionit të lartë.

## Konkluzione dhe rekomandime

Nevojitet që të unifikohet metodologjia për grumbullim dhe përpunim të të dhënave nga institucionet, sepse jo rrallë hasen mospërputhje në të dhënat statistikore në raport me konfiskimin me të cilat disponojnë gjykatat, prokuroritë dhe organet e tjera siç është Enti shtetëror për statistikë. Shumë shpesh të dhënat nuk mund të kryqëzohen dhe të krahasohen për shkak mospasjes së qasjes së barazuar nga institucionet, posaçërisht prokuroritë publike dhe policia financiare, për shkak të të cilës është e pamundur që në mënyrë përkatëse të ndiqet procedimi nga kompetentët në të gjitha fazat e procedurës, si dhe bashkëpunimi dhe koordinimi i tyre i ndërsjellë. Gjithashtu, institucionet kompetente grumbullojnë jashtëzakonisht pak të dhëna për aplikimin e konfiskimit të cilat më shpesh janë të dhëna lumare për një ose dy indikatorë (sh. vetëm një numër i personave nga të cilët konfiskohet pronë dhe vlerë e përgjithshme e pronës). Këto të dhëna pothuajse kurrë nuk janë të përpunuara dhe të analizuar nga vetë institucionet. Këto të dhëna pothuajse kurrë nuk janë të përpunuara dhe të analizuar nga vetë institucionet, e as që ekzistojnë modifikime të metodologjisë për tu grumbulluar më tepër të dhëna dhe të dhëna relevante me qëllim të zbulimit të shkaqeve që qëndrojnë prapa problemeve që paraqiten në zbatimin praktik të konfiskimit, e me atë edhe avancimin e gjendjes.

Për këtë shkak, ka nevojë që të bëhet revizion i metodologjisë për grumbullim të të dhënave, si dhe të

mundësohet grumbullim të numrit sa më të madh të të dhënave për më tepër aspekte të punës operative të institucioneve kompetente, me çka do të mundësohej ndjekja e aplikimit të masës në raste individuale nëpër të gjitha fazat e procedurës (hetim, procedurë gjyqësore, ekzekutimi i masës). Në mënyrë shtesë, me rëndësi të jashtëzakonshme do të jetë aplikimi i sistemit të integruar për grumbullim dhe përpunim të të dhënave, si dhe përfshirjen e Ministrisë së drejtësisë, Këshillit gjyqësor, Këshillit të prokurorëve publik, si dhe të Gjykatës Supreme në sistemin e tillë të integruar, me qëllim që të njëjtit të mund të kenë në dispozicion të dhëna qenësore për evaluimin dhe avancimin e aplikimit të konfiskimit, posaçërisht në rastet me korrupsion të lartë.

Duke i pasur parasysh nocionet e ndryshme të përdorura në ligjet, si dhe vështirësitë në praktikën e përkufizimit të konfiskimit dhe marrjes së sendeve, ka nevojë që të bëhet barazimi i terminologjisë së përdorur në ligjet (KP, LPP dhe Ligjin për menaxhim me pronën e konfiskuar), si dhe të bëhet përkufizim përkatës i masave konfiskim dhe marrje të sendeve të cilat janë të dedikuara për kryerje të veprës penale ose të cilat burojnë nga vepra penale me çka do të përmirësohej cilësia e të dhënave statistikore në pikëpamje të aplikimit të konfiskimit të pronës së përfutur në mënyrë jolegale. Në praktikë ekziston përdorimi i alternuar e nocioneve marrje të sendeve dhe konfiskimi i pronës, kështu që shpesh herë ndodh

që të dhënat statistikore të jenë më të larta nga shifra reale e pronës së konfiskuar e cila është fituar në mënyrë jolegale.

Ka nevojë që të bëhen ndryshime përkatëse të LPP, me çka do të mundësohej aplikimi përkatës i konfiskimit. Këtu, para së gjithash, mendohet në definimin e propozimit, përkatësisht të kërkesës për konfiskim nga prokurori publik, harmonizimi të dispozitave të konfiskimit me modelin e ri adversijal të procedurës penale të aplikuar me ndryshimet e LPP në vitin 2010 të cilët hynë në fuqi në vitin 2013, avancim të pozitës së personave të tretë dhe aplikim i mënyrave përkatëse ligjore për praktikum dhe mbrojtje të të drejtave të tyre në procedurat për konfiskim ku të njëjtat marrin pjesë, mandej përpunim të dispozitave që kanë të bëjnë me konfiskimin e zgjeruar, si dhe konfiskimin në situatën kur është e pamundur të iniciohet procedurë penale.

Ka nevojë që të punohet në fuqizimin e kapaciteteve të institucioneve kompetente, kështu që ka nevojë për rritje të buxhetit të Prokurorisë themelore publike për ndjekje të krimit të organizuar dhe të korrupsionit, sepse i njëjti mjafton vetëm për mbulim të rrogave të rrogave të prokurorëve dhe të shpenzimeve të përgjithshme. Për shkak të kësaj PTHP PKPK nuk ka buxhet të mjaftueshëm për zhvillim të resurseve njerëzore dhe për avancim të pajimit teknik dhe teknologjik të të njëjtës. Në drejtim të kësaj, në pajtim me sistematizimin e vendeve të punës në PTHP PKPK mungojnë 11 prokurorë dhe 11 bashkëpunëtorë profesional. Prokuroria nuk disponon me qendër të vetën hetimore, ndërsa në dispozicion ka vetëm 3 hetues që i janë ndarë nga MPB. PTHP PKPK nuk ka

kapacitete të mjaftueshme që në mënyrë të pavarur të zbatojë hetime financiare edhe përkundër obligimit ligjor që të njëjtës ti sigurohet qendër hetimore, si dhe përkrah praktikave dhe përvojave të mira të Prokurorisë së posaçme publike, qendrat e të cilës të hetimit u treguan kyçe në hetimin e formave komplekse të korrupsionit dhe të krimit të motivuar financiarisht.

Mungon strategji për qasje të integruar të më tepër shërbimeve dhe udhëheqje paralele e hetimit financiar dhe penal. Hetimet financiare pothuajse pa përjashtim zbatohen para fillimit të hetimit penal dhe shërbejnë si bazë për ngritje të hetimit penal. Hetimet e tilla jo vetëm që udhëhiqen pa koordinim me prokuroritë publike por edhe në kuadër të të njëjtave mungon ndjekje përkatëse e rrjedhës së parave, si dhe zbulimi i shkrirjes, transferimit dhe fshehjes eventuale të pronës së fituar në mënyrë joligjore. Për shkak të kësaj, ka nevojë të punohet në fuqizimin e koordinimit të prokurorive publike me policinë financiare, MPB dhe shërbimet e tjera, si dhe të punohet në fuqizimin e kapaciteteve të organeve hetimore, para së gjithash përmes trajnimeve dhe stërvitjeve të ndryshme për zbatimin e hetimeve bazike financiare në kuadër të procedurave penale, si dhe ngritje e vetëdijes te kompetentët për domethënien dhe rëndësinë e aplikimit të konfiskimit, posaçërisht në lëndët e ndërlydhura me korrupsionin dhe krimin financiarisht të motivuar.

Për shkak të mungesës së hetimeve në kohë dhe me themel, prokurorët shumë rrallë kërkojnë aplikim të masës së konfiskimit në fazat e hershme të



procedurës, gjë e cila do të thotë edhe mungesë e masave për sigurim të pronës me çka do të mundësohej ekzekutimi i masës konfiskim. Në drejtim të kësaj, nevojitet avancimi i komunikimit dhe të koordinimit të PTHP PKPK me organet e tjera hetimore si policia hetimore, drejtoria për zbulim financiar. MPB e ngjashëm. Në mënyrë shtesë, nevojitet edhe fuqizimi i trajnimeve për prokurorët publik në pikëpamje të ndjekjes së korrupsionit të lartë dhe të krimit të "jakave të bardha", si dhe fuqizimi i kapaciteteve të tyre për udhëheqje të hetimeve përkatëse dhe procedim të argumentuar para gjykatës, me qëllim që para të njëjtës të prezantohen sa më tepër dëshmi. Në këtë mënyrë, jo vetëm që do të maksimizohet mundësia për konfiskim të cilës do qoftë pronë të përfituar në mënyrë jolegale, pavarësisht nëse është drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë nga vepra penale, por edhe do të minimizohet rreziku nga transferimi i dëshmimit dhe të shkeljes së të drejtës për gëzim të lirshëm të pronës.

Është detektuar se mungon shqiptimi i masës konfiskim nga ana e gjykatave themelore në Maqedoni, me përjashtim të Gjykatës Themelore penale Shkup, madje edhe në rastet kur ajo është e nevojshme, gjë e cila është tregues shtesë për mos-fleksibilitet të gjykatave dhe organeve të përndjekjes të cilat ende në mënyrë dominante shërbejnë që personi i dënuar ta kthejë shumën e përfituar në mënyrë jolegale. Pa marrë parasysh se Gjykata themelore penale ndahet nga gjykatat e tjera në vendin tonë, më së shumti për shkak të departamentit për krim të organizuar dhe të korrupsionit, prapëseprapë edhe në këtë gjykatë shqiptohen shumë pak vendime për konfiskim ose

mesatarisht nën 10 në nivel vjetor. Pjesa më e madhe e masave të shqiptuara të konfiskimit janë në procedurat e ndërlidhura me krimin e organizuar dhe me korrupsionin, por prapëseprapë të njëjtat kanë të bëjnë me vepra korruptuese penale vetëm në 5% nga të gjitha rastet kur është shqiptuar konfiskimi. Për këtë shkak nevojitet angazhim i shtuar e Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik, në pikëpamje të organizimit të trajnimeve të trajnimeve për masën e konfiskimit, si dhe udhëheqja e evidencës përkatëse në pikëpamje të asaj se cilët dhe sa gjykatës kanë vijuar trajnime të tilla, si dhe përpjekje nga të gjithë faktorët e tjerë relevant që të punojnë në ngritje të vetëdijes dhe të avancimit të gjendjeve në pikëpamje të shqiptimit të konfiskimit.

Nëse merren parasysh problemet e ndryshme të cilat mund të burojnë nga ruajtja e përkohshme e pronës për shkak të sigurimit, si dhe gjatë ekzekutimit të vendimeve fuqiplote të konfiskimit, rekomandohet që Agjencia për menaxhim me pronë të konfiskuar dhe me përfitimin nga prona të disponojë me buxhet të vetin, si dhe të parashihen rregulla ligjore dhe mekanizma për fuqizim të përgjegjësisë dhe të llogaridhënies në punën e Agjencisë në pikëpamje të zbatimit të masës së konfiskimit në procedurat penale. Në këtë mënyrë do të mundësohet që Agjencia në mënyrë përkatëse ti përmbush obligimet e veta ligjore, do të minimizohet rreziku nga procedimi i neglizhent me pronën dhe zvogëlimi i vlerës së saj dhe do të fuqizohen angazhimet e Agjencisë në pikëpamje të shitjes ose shfrytëzimit të sërishëm të pronës së konfiskuar.

